

MARRËVESHJE SHITBLERJE KUOTE

Kjo MARRËVESHJE është lidhur më 30.12.2021.

NDËRMJET:

- 1) **Lantona Sado**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 04.07.1974, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H45704045P ("**Shitësi**"); dhe
- 2) **Bardhyl Sado**, shtetas shqiptar, lindur në Përmet, më 30.12.1938, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal: D81230033H ("**Blerësi**").

HYRJE:

- (A) Shitësi është zotëruesi i 1 (një) kuote që përfaqëson 50% të kapitalit ("**Kuota e Shitur**") në shoqërinë **PDFSHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L81710031G ("**Shoqëria**").
- (B) Sipas nenit 9.1 të Statutit të Shoqërisë **PDF SHPK**, *Ortakët e Shoqërisë nuk mund të shesin, transferojnë, cedojnë, dhurojnë, vendosin peng, transferojnë pronësinë e zhveshur ose uzufuktin, hipotekojnë ose barrësojnë ndonjë pjesë ose tërësinë e kuotave të tyre në Shoqëri ose bien dakord për ndonjë nga këto akte pa vendimin paraprak me shkrim të asamblesë së përgjithshme me të paktën ¾ e votave. Sa më sipër dhe parashikimet e neneve 9.2 e vijues më poshtë, nuk do të zbatohen për veprimet e kryera me ose në favor të Personave të Lidhur të secilit ortak*".
- (C) Blerësi është Person i Lidhur me Shitësin, sipas përkufizimit të Statutit të Shoqërisë, duke qenë babai i saj (vërtetuar nga Certifikata Familjare/Personalee Shitësit) dhe prandaj Shitësi mund t'i transferojë lirisht Kuotën e Shitur.
- (D) Shitësi dëshiron të shesë dhe Blerësi dëshiron të blejë Kuotën e Shitur sipas parashikimeve në vijim.

PALËT BIEN DAKORD si vijon:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1.1 Termat në vijim do të kenë kuptimin si më poshtë vijon:

"**Marrëveshje**" është kjo Kontratë Shitblerje Kuote.



"Barra" është çdo interes ose kapital i çdo personi (përfshirë çdo të drejtë për të blerë, opSION ose të drejtë parablerjeje) ose çdo hipotekë, detyrim, peng, barrë, dhënie të drejte, hipotekë, interes sigurie, mbajtje titulli ose marrëveshje tjetër sigurie ose marrëveshje.

"Kuota e Shitur" është 1 (një) kuotë në Shoqëri, e emetuar dhe paguar plotësisht dhe e cila përbën 50% të kapitalit të Shoqërisë.

1.2 Për shmangien e dyshimeve, kjo Marrëveshje është dokumenti që përbën transferimin e Kuotës së Shitur nga Shitësi tek Blerësi dhe dokumenti i vetëm që kërkohet të regjistrohet pranë çdo autoriteti ku kërkohet regjistrimi i këtij transaksioni.

2. SHITJA DHE BLERJA

2.1 Sipas afateve dhe kushteve në vijim, Shitësi shet dhe Blerësi blen, me garanci të plotë të titullit dhe të lirë nga çdo barrë, Kuotën e Shitur dhe çdo të drejtë të lidhur me Kuotën e Shitur.

3. CMIMI I BLERJES

3.1 Çmimi i blerjes për Kuotën e Shitur është vlera nominale e saj, 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë.

3.2 Çmimi i blerjes do të paguhet në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, në çfarëdo mënyre të përshtatshme për Blerësin.

4. TRANSFERIMI I TITULLIT TË KUOTËS

4.1 Titulli i Kuotës së Shitur i transferohet Blerësit menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Pas transferimit të Kuotës së Shitur, Blerësi do të zotërojë 1 (një) kuotë që përfaqëson 50 % të kapitalit dhe do të bëhet njëri prej ortakëve të Shoqërisë.

4.3 Ortakët e Shoqërisë pas transferimit të Kuotës do të jenë si më poshtë:

- Andi Kodra, 1 kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit

- Bardhyl Sado, 1 kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit

5. GARANCI TË TJERA

Shitësi do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që çdo palë e tretë e nevojshme të nënshkruajë dhe dorëzojë menjëherë dokumentet dhe kryejë veprimet që Blerësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për t'i dhënë Blerësit titullin e plotë, të pabarrësuar, ligjor dhe pronësinë përfituese në dhe për Kuotën e Shitur.

6. NDRYSHIMET

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë i vlefshëm përveçse nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët (ose përfaqësuesit e autorizuar nga to).

7. EKZEMPLARË

- 

- 

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në çfarëdolloj numri ekzemplarësh, secili prej të cilëve është origjinal kur nënshkruhet dhe dorëzohet dhe të gjithë së bashku evidentojnë të njëjtën marrëveshje.

Kjo Marrëveshje është lidhur në datën e shënuar në fillim të saj.

Shitësi

Lantona Sado

Lantona Sado
fodg

Blerësi

Bardhyl Sado

Bardhyl Sado
fodg